



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (QRK) - NR.16/2024 PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET EDUKATIVE, SHËNDETËSORE
APO REHABILITUESE PËR FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË
NJË KOMUNË TJETËR¹**

¹ Rregullore (QRK) – Nr.16/2024 për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për mbulimin e Shpenzimeve për Shërbimet Edukative, Shëndetësore apo Rehabilituese për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar në një Komunë tjetër, është miratuar në mbledhjen e 203 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim Nr.07/203, të dates 08.05.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Nenin 46, paragrafi 4 të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në pajtim me nenin 8 paragrafi 4 (nën paragrafi 4.5) i Ligjit Nr. 08/117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 19 paragrafi 6 (paragrafit 6.2) të Rregullores së Punës të Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, datë 12 shtator 2011),

Miraton:

RREGULLORE (QRK) - NR. 16/2024 PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET EDUKATIVE, SHËNDETËSORE APO REHABILITUESE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË NJË KOMUNË TJETËR

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGGJTHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar në përputhje me nevojat specifike të tyre, në një komunë tjetër nga ajo ku jeton fëmija.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga të gjitha institucionet publike të nivelit lokal që ofrojnë shërbime edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijë me aftësi të kufizuar.

Neni 3 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me kuptimin e dhënë në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

Neni 4 **Parimet udhëheqëse**

1. Të gjitha veprimet, masat dhe vendimet që ndërmerren udhëhiqen nga parimet e:

1.1. qasjes miqësore;

1.2. veprimit ndërdisiplinor;

1.3. koordinimit ndërmjet institucioneve dhe akterëve institucional të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të planifikuara.

KAPITULLI II **IDENTIFIKIM I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI I SHËRBIMEVE**

Neni 5 **Identifikimi i nevojave dhe planifikimi i shërbimeve brenda komunës**

1. Komuna identifikon nevojat për shërbime edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar.

2. Komuna planifikon në baza vjetore buxhetin për sigurimin e shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 6 **Ofrimi i shërbimeve**

1. Secila Komunë ofron shërbimet edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar me vendbanim apo vendqëndrimin në territorin e asaj komune në përputhje me nevojat specifike të fëmijës.

2. Komuna e cila nuk ka shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni, bashkëpunon me komunën tjetër për ofrimin e shërbimeve përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Neni 7 **Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve në një komunë tjetër**

1. Me qëllim të ofrimit dhe sigurimit të shërbimeve edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar, dy ose më shumë komuna bashkëpunojnë në ofrim të shërbimeve në pajtim me legjislacionin në fuqi sipas nevojës së komunës.

2. Komuna përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuar kujdeset që shërbimet përkatëse të ofrohen sa më afër vendbanimit apo vendqëndrimit të fëmijës.

KAPITULLI III

MBULIMI I SHPENZIMEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN TJETËR

Neni 8

Mbulimi i shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve në komunën tjetër

1. Shpenzimet për ofrimin e shërbimeve për fëmijën me aftësi të kufizuar në një komunë tjetër nga ajo ku jeton fëmija mbulohen nga buxheti i komunës që e kërkon shërbimin përkatës.
2. Komuna e cila e ka të themeluar shërbimin përkatës siguron funksionimin e institucionit brenda të cilit ofrohen shërbimet.
3. Komuna nga paragrafi 2 i këtij neni ofron shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar të përshtatura sipas nevojave të fëmijës.

Neni 9

Procedura

1. Komuna që nuk e posedon shërbimin përkatës, përmes kërkesës me shkrim i drejtohet komunës që e ofron atë shërbim për t'i ofruar shërbimin për fëmijën me aftësi të kufizuar.
2. Komunitat mund të lidhin marrëveshje për mbulimin e shpenzimeve për ofrim të shërbimeve edukative, shëndetësore apo rehabilituese.
3. Drejtoria për arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale në komunën kërkuese për ofrimin e shërbimit përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për fëmijën me aftësi të kufizuar.

Neni 10

Kartela e Shërbimeve

Komuna ofruese e shërbimeve i pajisë me kartela të shërbimeve fëmijët me aftësi të kufizuar që marrin shërbime përkatëse.

KAPITULLI IV

BASHKËPUNIMI

Neni 11

Mbajtja dhe raportimi i të dhënave

1. Komunitat palë në marrëveshje i ofrojnë njëra tjetrës informata dhe të dhëna mbi shërbimet e ofruara për fëmijën me aftësi të kufizuar.
2. Komuna ofruese e shërbimeve mbanë evidencë për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar si dhe e informon komunën tjetër ku fëmija ka vendbanimin apo vendqëndrimin mbi zbatimin e planit të shërbimeve.

3. Evidenca nga paragrafi 2 i këtij neni përmban:

- 3.1. të dhënat personale të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 3.2. informacionin për rastin;
- 3.3. shërbimet e ofruara;
- 3.4. pengesat për qasje në shërbime, bazuar në raste specifike.
- 3.5. rekomandime për shërbime të tjera.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

10 Maj 2024